



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/28

Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Integritimit Evropian, për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës autorizimin për nënshkrimin e "Marrëveshjes bilaterale në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të madh të Luksemburgut në kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistenca teknike në kontekstin e Integritimit Evropian".
2. Kërkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës që autorizimi për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi të jepet në përputhje me dispozitat dhe afatin e përcaktuar në nenin 7 të ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/28
Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Ministrisë, Shkencës dhe Teknologjisë për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin "Erasmus Plus".
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në pajtim me afatin e përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/28

Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të ish Ndërmarrjes Shoqërore "Sharrprodhimi" të cilat preken nga realizimi i Projektit për ndërtimin e "Qendrës së Komunitetit" dhe Ndërtimi i "Shtëpisë së Kulturës" për nevojat e qytetarëve të fshatit Restelicë, Komuna Dragash, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Dragashit.
4. Kompensimi i pronave, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Komuna e Dragashit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/28

Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga Ndërtimi i Rrugës Regjionale Deçan-Kozhner, Zona Kadastrale Hulaj, Komuna Deçan, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/28
Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 221, datë 22.01.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i parcelës kadastrale nr. 1305-0 (pronë shoqërore) e cila preket nga ndërtimi i Stacionit Policor në Komunën e Zubin Potokut, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabela pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 4535/17 datë 14.09.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelën pjesë përbërëse e këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/28
Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 263, datë 23.01.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM: Pika Kufitare Merdar, Zona Kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 238/18 datë 18.01.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelën e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/28
Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për financimin e projektit "Programi i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta – BMZ ID 2015 67 049".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/28

Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për financimin e projektit për "Shërbime Profesionale të Pranuesit në kuadrin e Programit II të Menaxhimit të Mbeturinave të financuar nga një fond i veçantë nr. 12765".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/28

Datë: 05.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me nr. prot. 354, datë 01.02.2018, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për dhënien e pajtimit për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
2. Qeveria pajtohet që të përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji për shkak të specifikave që ndërlidhet me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë/sekretit të ligjshëm dhe interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të datës 1 shkurt 2018.
3. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë